

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24), duke vepruar mbi bazën e njoftimit për përqendrim të parashtruar nga SAVP Holding d.o.o. Beograd, me seli në Gospodara Jovanova 73, Beograd, Republika e Serbisë, dërguar përmes Shoqërisë së Avokatëve Debarliev, Dameski dhe Qeleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 20.01.2024, miratoi këtë

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin SAVP Holding d.o.o. Beograd, me seli në Gospodara Jovanova 73, Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll të plotë mbi SAGA MK SHPKNJP Shkup, me seli në rruga Vasil Glavinov, nr. 14- mezanin/2, Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet blerjes së drejtpërdrejtë të 100% të pjesës në SAGA MK SHPKNJP Shkup, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 29.10.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) ka pranuar një njoftim për përqendrim nga SAVP Holding d.o.o. Beograd, me seli në Gospodara Jovanova 73, Beograd, Republika e Serbisë, me të cilin SAVP Holding d.o.o. Beograd do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi SAGA MK SHPKNJP Shkup, me seli në rruga Vasil Glavinov, nr. 14- mezanin /2, Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, nëpërmjet blerjes të drejtpërdrejtë të 100% të pjesës në SAGA MK SHPKNJP Shkup.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij konstatoi si vijon:

SAVP Holding d.o.o. Beograd është një kompani e sapothemeluar më 03.08.2023 si kompani holding. SAVP aktualisht nuk kryen asnjë aktivitet dhe nuk ka të ardhura.

SAVP Holding d.o.o. Beograd nuk ka prani të korporatave në Maqedoninë e Veriut.

SAGA MK SHPKNJP Shkup është në pronësi 100% të SAGA d.o.o. Beograd, me seli në bulevardin Zoran Gjingjica 64a, Novi Beograd, Republika e Serbisë.

Aktivitetet e biznesit të SAGA MK janë të fokusuara në fushën e projektimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së TI-së për nevojat e kompanive të tjera. Gjithashtu ofron shërbime të instalimit të harduerit, mirëmbajtjes së pajisjeve IT, zhvillimit dhe shitjes së softuerëve, si dhe servisimit të produkteve të kompanive të tjera. Aktivitetet e saj përfshijnë edhe instalimin e kablove në sektorin e telekomunikacionit.

SAGA MK nuk ka pjesëmarrje në kompani të tjera në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска

